

K O N T R A T E

PER KRIJIMIN E SHOQERISE "SEFA N. & i biri import -eksport" sh.p.k.

Sot me dt.25/07/1994 NEBI SEFA ,i biri i Ismailit dhe i Shehriarit lindur ne Tirane me 6/05/1944,me banim ne Kavaje ne rrugen Mehmet Babamusta 63, me vullnetin e tij te lire vendosi te krijoje shoqerine "SEFA N.&i biri import -eksport" sh.p.k. me kushtet e meposhteme:

Neni I Shoqeria "SEFA N.&i biri import-eksport" sh.p.k. ka si objekt te veprimtarise se saj prodhimin dhe tregtimin e te gjitha llojeve te produkte vet te karakterit industrial dhe bujqesor,te materialeve te ndertimit import-eksportin e tyre si dhe te paisjeve e maqinerive te gjitha fushave te industrise,bujqesise,transportit dhe ndertimit,te sherbimit social.

Neni II

Shoqeria ka qendren e saj ne Lushnje nendertesën e saj ne lagjen Clirimi prane Tipografise.

Neni III

Shoqeria do te kete jetegjatesi mbi dhjete vjet.

Neni IV

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 120 miqe leke te arketuar ne Banke. (nje qind miqe)

Neni V

Shoqeria ka nje ortak te vetem zotin Nebi Sefa i cili eshte administratori i saj.

Neni VI

Kjo kontrate eshte pjese perberse e dokumentave krijuese te shoqerise dhe se bashku me statutin i paraqiten per miratim Gjykates Rrethit T,rane.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT DURRES
NOTERIA NR. 257/1994

O R T A K U

i
V E R T E T I M

Sot, me daten 25/07/1994, Para meje Elda Mihal Puli ,Notere ne qytetin e Durresit ,u paraqit personalisht Nebi Sefa identitetin e te cilit e provova me ane te leternjoftimit personal, icili me deklaroi se kontrata e krijimit te shoqerise,si me siper eshte bere sipas vullnetit te tij te lire e te plote e ne baze te ligjit e nenshkruan para meje Noteres.



NOTERE
(Elda Puli)

STATUT

I SHOQERISE "SEFA N. & I BIRI IMPORT EKSPORT" sh.p.k.

KREU I.

Neni 1.

Ne baze te ligjit 7512dt.10/08/1991 "per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe te privatizimit" dhe ligjit 7638 dt.19/02/1992 "per shoqerite tregtare" me vullnetin etij te lire ortaku:Nebi Sefa krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "SEFA N. & I BIRI IMPORT, EKSPORT". Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe normat e akteve te saj krijuese.

Neni 2.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: PRODHIMI DHE TREGTIMI I TE GJITHA LLOJEVE TE PRODUKTEVE TE KARAKTERIT INDUSTRIAL DHE BUJQESOR, TE MATERI ALEVE TE NDERTIMIT, IMPORTIMI DHE EKSPORTIMI I TYRE SI DHE TE PAISJEVE E MAQINERIVE TE TE GJITHA FUSHAVE TE INDUSTRISE, BUJQESISE, TRANSPORTIT, NDERTIMIT E TE SHERBIMEVE SOCIALE TE TE GJITHA NATYRAVE.

Neni 3.

Qendra e shoqerise eshte ne Shqiperi-Lushnje, lagjja Clirimi ne ndertesen e vet private ngjitur me Tipografine. Me vendim te administratorit shoqeris mund te krijoje qendra dytesore apo agjensi ose perfaqesi ne qytete apo vende te tjera. Qendra e ortakeve shenohet ne Librin e Shoqerise.

Neni 4.


Jetegjatesia e shoqerise eshte 20 vjet. Shoqeria mund te shperndahet perpara ketij afati me vendim te asamblese te ortakeve, ose kur verifikohen rrethete tilla kur shperndarja e saj urdherohet ne menyre te shprehur nga ligji.

KREU II.

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT.

Neni 5.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shuma prej 100.000 (njqint mije) lek te arketuara ne Banke. Ky kapitak eshte arketuar ne banke nga ortaku i v. Z. Nebi Sefa, qe rrjedhimisht eshte administratori i saj. Pjese te kapitalit nuk mund te perfaqesohen ne sherbime apo letra me vlere te tregtueshme.



KONTRIBUTET jane teresisht te shlyeshme e te nenshkrueshme nga ortakët.

Neni 6.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne kuota vlera minimale e te cilave eshte I.000 leke, ose shumefishi i tyre.

Neni 7.

Natyshinet ne kapitalin themeltar si per shtimin apo zvoglimin e tij behen me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 8.

Kuotat jane nominative dhe lirisht te transferueshme midis ortakëve. Transferimi i kuotave behet vetem me akt noterial. Cdo transferim i kuotave tek te tretet i nenshtrohet te drejtes para blerjes nga ana e ortakëve te tjer.

Neni 9.

PER tjetersimin e kuotave te te tretteve ortaku duhet te njoftoje shkrese risht shoqerine dhe secilin ortak, shoqeria mbrenda tre muajve nga dita e marrjes dijeni duhet te jape vendimin per lejimin e transferimit, vendim icili kerkon shumicen pro te parashikuar ne dispozitat per organet e shoqerise. Kur nje vendim te tille shoqeria nuk e komunikon mbrenda tre muajve, miratimi per transferimin konsiderohet i dhene. Në raste shoqeria jep nje vendim i cili nuk miraton kerkesen, cdo ortak per tre muaj duhet te ushtroje te drejten e parablertes. Ne te kunderten kuotat jane te lira t'u transferohen te tretteve. Në rast se lind nevoja per vleresimin e kuotave ortakët caktojne ekspert. Ne rast se nje gje e tille nuk arrihet te behet me marreveshtje mes tyre eksperti caktohet nga ana e Gjykata e Rrethit te Tiranes.

Neni 10.

Bashkimi i pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise ne nje dore te vetme nuk passjell shperberjen e shoqerise.

Neni 11.

Shoqeria ka te drejte te lere peng pjese te pasurise se saj. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar pjese te kapitalit, me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i riblje keto pjese e te deklaroje zvoglimin eventual te kapitalit te saj themeltar.

Q. L. L. L.

KREU III.

ORGANET E SHOQERISE. ASAMBLEJA E ORTAKEVE.

Neni 12.

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise. Vendimet esaje te marra ne perputhje me ligjin e me normat e akteve krijuese te shoqerise jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, duke perjashtuar te drejten e tyre te ankimit kunder vendimeve qe ato i çmojne te demshme per interesat e tyre.

Neni 13.

ASambleja e ortakeve thirret nga administratori ose eksperti kontabel dhe mbahet rregullisht ne qendren e shoqerise. Thirrjet behen me shkrim dhe ju komunikohen ortakeve ne vendbanimet e tyre te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Ne thirrje shenohen vendi, koha, dhe rendi i dites i mbledhjes.

Neni 14.

Cdo ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e ASamblese nga nje ortak tjeter ose person i trete, mjaft qe ai te mos jete administrator i shoqerise. Mandatet e perfaqesuesve verifikohen nga drejtuesi i mbledhjes.

Neni 15.


Nje ortak nuk mund tengarkoje nje perfaqesues te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij, duke votuar, ai vete n'emer te pjeses tjeter te kapitalit themeltar.

Neni 16.

Cdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote ne zoterim. Vendimet e ASamblese merren me votat e ortakeve qe perfaqesojne 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 17.

ASambleja drejtohet nga administratori i cili ngarkon nje sekretar per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.



KREU IV.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE.

Neni 18.

Shoqeria administrohet nga nje ortak i vetem i cili eshte ortaku themelues
Z. NEBI SEFA.

Neni 19.

Mandati i administratorit eshte i pakufizuar ne kohe. Shoqeria mund te revo
koje mandatin e administratorit me shumicen e siperme te votave ne Asambler
e Ortakeve.

Neni 20.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit
ne interes te shoqerise qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise
se saj, me perjashtim te kompetencave qe me ligje jane te Asamblese te
Ortakeve .

Neni 21.

Administratorit i takon firma e shoqerise dhe e drejta e perfaqesimit te
saj perpara te treteve.

Neni 22.

Shoqeria merr detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit dhe kur
ato nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se saj me perjashtim te ras
teve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit tejka
lon objektin e veprimtarise se shoqerise, ose te tretet ne rrethana te
caktuara nuk mund ta injoronin kete fakt.

Neni 23.

Administratorit i ndalohet te kontraktoje me shoqerine ne çdo forme. Ai
pergjigjet perpara shoqerise per veprimet e kryera ne kundërshtim me li
gjin, statutin apo per faje te kryera gjate ushtrimit te detyres. Pasojat
e marrveshtjeve te pa miratuara nga Asambleja e Ortakeve qe i sjellin dem
shoqerise i ngarkohen administratorit.

KREU V.

KONTROLI I ORTAKEVE.

Neni 24.

Cdo ortak jo administrator ka te drejte qe dy here ne vit t'i paraqese
kerkese me shkrim administratorit per te kerkuar sqarime lidhur me vazhdimi

Nebi Sefa

e veprimtarise se shoqerise. Pergjigja e administratorit i komunikohet ekspertit kontabel

Neni 25.

Asambleja ose Gjykata emron ekspert kontabel, te cilet kane nje mandat prej 6 muajsh.

Neni 26.

Shoqerija do te jete e detyruar te emeroje ekspert ne se verifikohen kush tet e meposhteme :

- Bilanci ne fund te vitit financiar eshte I2 milion leke.
- Vlera e te ardhurave nga qarkullimi, pasi eshte zbritur tatimi mbi qarkullimin ne mbyllje te vitit eshte 24 milion leke.
- Shoqeria ka mesatarisht mbi 50 te punesuar gjate vitit financiar.

KREU VI.

BILANCI DHE FITIMET.

Neni 27.

VITI financiar i shoqerise mbylletme 31/I2 te çdo viti. ME kete rast administratori ben inventarin dhe llogaritesipas dispozitave per kontabilitet: si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin. Bilancit i bashkohet:

- Nje situacion per garancite e dhena nga shoqerija.
- Nje situacion per sigurimet e bera nga shoqerija.

Keto dokumenta vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te pakten nje muaj perpara mbledhjes se ASamblese.

Neni 28.

Perderisa "rezerva e domosdoshme" te arrije 1/10 e kapitalit themeltar, shoqerija eshte e detyruar te depozitoje ne fund te çdo viti 1/20 e fitimit te shoqerise.

Neni 29.

Fitimet, pasi jane lene shumat eurdheruara per rezerven etj. ndahen midis ortakeve ne perputhje me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 30.

Bilanci vjetor duhet te paraqitet mbrenda dates 31/3 te vitit pasardhes.

Neni 31.

Ortaketqi konsiderojne dividendet jo ne perputhje me fitimet e realizuara kane te drejte qe mbrenda 3 vjeteve tua reklamojne kete ortakve te tjere.

Handwritten signature

KREU VII.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME.

Neni 32.

Organi kompetent per te zgjidhur mosmarreveshtjet e mundeshme mes ortakve eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

Neni 33.

Cdo mosmarrveshtje qe mund te linde e qe nuk eshte rregulluar shprehimisht ne kete statut e kontrate qe i bashkohet do t'i nenshtrohet rregullimit ligjor te legjislacionit shqiptar.

Neni 34.


Ne rast te likuidimit te shoqerise caktohet likuidusi, i cili caktohet me votat e shumices te cilesuar ne nenin I7 te ketij statuti.

Ne te kunderte me kerkese te secilit ortak apo te interesuari likuidusi caktohet nga gjykata.

Neni 35.

Gjate funksionimit te tij likuidusi perfaqeson qe perkohesisht emrohet "shoqeri ne likuidim"

O R T A K E T



Republika e Shqiperise

Gjykata e Rrethit ~~DURRES~~ DURRES

NOTERIA Nr. 7576/3237

Sot, ne daten 25/07/1994 PARA meje Elda Mihal Puli, Notere ne qytetin e Durresit u paraqit personalisht Z.Nebi Sefa per identitetin e te cilit u sigurova nga leter njoftimi personal icili me deklaroi se statuti i me sipërme eshte i hartuar sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote e ne baze te ligjes e nenshkruan perpara meje, N^oteres.

NOTERE

(Elda Puli)

